

## FTESË

### Konventa Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023

#### Grupi i Punës II (Drejtësia, Liria, Siguria)

#### Sesioni 1, Tema: Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare

27 maj 2022, 10:00 – 12:00

Online në Platformën ZOOM

Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA) në bashkëpunim me Slovak Foreign Policy Association, me mbështetjen financiare të SlovakAid ju fton në **Sesionin 1 të Grupit të Punës II (Drejtësia, Liria, Siguria)** “Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare” që po organizohet në kuadër të **Konventës Kombëtare për Integrimin Europian 2021-2023**.

Konventa fokusohet në 3 drejtime kryesore: 1) rritja e pjesëmarrjes së të gjithë segmenteve të shoqërisë shqiptare (përfshirë edhe nivelin lokal); 2) institucionalizimi i debatit publik në çështjet e BE-së bazuar në bashkëpunimin e institucioneve publike, organizatave të shoqërisë civile dhe ato të biznesit; dhe 3) forcimi i kapaciteteve në negociatat për integrimin në BE përmes transferimit të njohurive sllovaqe.

Në sajë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me ministrinë dhe agjencitë kyçe gjatë periudhës 2014-2021 si Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Bujqësisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit, janë krijuar disa grupe pune për të adresuar kapitujt më sfidues të negociatave të acquis së BE-së. Deri më tani janë organizuar më shumë se 40 sesione të grupeve përkatëse të punës dhe 4 aktivitete plenare, në të cilat ekspertë vendas dhe më shumë se 20 ekspertë nga Sllovakia kanë ndarë përvojën dhe ekspertizën e tyre. Këto sesione kanë mbledhur më shumë se 500 përfaqësues nga institucionet shtetërore (ministrinë, institucionet publike qendrore dhe lokale), nga sektori i shoqërisë civile, komuniteti i biznesit dhe shoqatat e punëtorëve, akademia dhe media, ku kanë marrë pjesë edhe përfaqësues nga organizma të huaj dhe organizata ndërkombëtare në Shqipëri.

Gjatë Konventës 2021–2023 po organizohen 16 sesione për katër Grupe Pune, më konkretisht: **GP I** – Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23); **GP II** – Drejtësia, Liria, Siguria (Kapitulli 24); **GP III** – Bujqësia dhe Mbrojtja e Konsumatorit (Kapitulli 11, 12 dhe 28); **GP V** – Çështjet e Tregtisë dhe Ekonomisë (Kapitulli 1, 2, 3, 4 dhe 20).

Në kuadër të **Grupit të Punës II** gjatë periudhës **2014-2021** janë organizuar më shumë se 10 sesione me tema dhe fusha që lidhen me drejtësinë, migracionin dhe azilin, luftën kundër krimit të organizuar, bashkëpunimit gjyqësor dhe liberalizimin e vizave. Për periudhën **2021-2023** janë planifikuar të organizohen **katër sesione** për këtë GP. **Sesioni 1** fokusohet te bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe financiare ku do të analizohet situata dhe zhvillimet në Shqipëri dhe do të ofrohen raste suksesi nga eksperiencia sllovaqe.

*Të dhënat e takimit në ZOOM janë si më poshtë:*

Zoom Link:

<https://us06web.zoom.us/j/88582412349?pwd=eGREekRsRy9WcmowK0ovamxudFJjUT09>

Meeting ID: 885 8241 2349

Passcode: NCEI-AL

*Ju lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj në: [info@em-al.org](mailto:info@em-al.org).*

*\*Gjatë aktivitetit do të ofrohet përkthim i njëkohshëm i gjuhës angleze*

## PROGRAMI

### **Konventa Kombëtare mbi Integrimin Europian 2021-2023**

**Grupi i Punës II (Drejtësi, Liri, Siguri)**

**Sesioni 1, Tema: Bashkëpunimi gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare**

**27 maj 2022, 10:00 – 12:00**

**Online në Platformën ZOOM**

**09:45 – 10:00** Regjistrimi i pjesëmarrësve

**10:00 – 10:10** Fjala përshëndetëse

**Gledis Gjipali**, Drejtor Ekzekutiv, Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)

**Peter Brezani**, Shoqata Sllovaqe për Politikën e Jashtme (SFPA)

**10:10 – 10:45** Veprat penale në çështjet financiare - kuadri ligjor i Shqipërisë dhe rastet praktike

**Assoc. Prof. Ersi Bozheku**, Avokat në Gjykatën e Lartë të Apelit, në Romë, Itali dhe Profesor në Universitetin e Romës, La Sapienza

- *Kuadri ligjor në Shqipëri dhe institucionet përgjegjëse*

- *Veprat penale në fushën e falimentit dhe rastet e evazionit fiskal*

- *Përgjegjësitë e lidhura me veprat penale në shoqëritë tregtare – raste praktike*

- *Bashkëpunimi me agjencitë europiane dhe me shtetet anëtare të BE – praktikat e suksesshme*

**10:45 – 11:00** Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

**11:00 – 11:45** Bashkëpunimi juridik në çështjet civile dhe tregtare– Eksperienca e Sllovakisë, si vend anëtar i Bashkimit Europian

**Prof. JUDr. PhDr Miroslav Slašťan, PhD**, Profesor në Departamentin e Drejtësisë dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Universiteti Comenius në Bratislavë

- *Eksperienca e Sllovakisë në krijimin dhe implementimin e kuadrit ligjor për njohjen dhe zbatimin e ndërsjellë të vendimeve*

- *Pjesëmarrja dhe eksperienca sllovaqe në Rrjetin Europian Gjyqësor në çështjet civile dhe tregtare*

- *Rekomandime se si të kemi një bashkëpunim efektiv, si të rrisim kapacitetet dhe të forcojmë bashkëpunimin me këto struktura.*

**11:45 – 12:00** Diskutim i hapur me pjesëmarrësit

**12:00** Mbyllja e takimit